

VENDIM
Nr.116, datë 3.2.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA,
QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE,
KOMUNA ODRIE TË QARKUT TË GJIROKASTRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Odrie të qarkut të Gjirokastrës, që do t’i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë e që përfundon me numrin rendor 9 (nëntë) dhe lidhja nr.1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Odrie për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

2.FORMULARI I LISTES PERFUNDIMTARE PER TRANSFERIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(Mbeshtetur ne inventarizimin e pronave te vecanta te tipit Pyje, Kullota,Livadhe,Shkembore etj.)

Institucioni Pushtetit Qendror										
MMPAU										
Komuna										
Komuna Odrie										
Nr Rend	Numri i pasurise sipas VKM	Emertesa e Ekonomise Pyjore dhe kullosore (EPK)	Emertesa e Ngastres Vendndodhja (sipas emerteses popullore	Numri i ngastres	Destinacioni	Siperfaqja ne ha	Funksioni per te cilin perdoret prona	Institucioni Enti me pergjegjesite administrative	Institucioni Enti perdoues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te vecanta)
1	63	EK Lunxheri	Bregu i Dimrudit	1a	K.dimerore	20	Kullote	MMPAU	K.Odrie	Ne perdorim
2	64	EK Lunxheri	Faqja e Manastirit	2	K.dimerore	74,5	Kullote	MMPAU	K.Odrie	Ne perdorim
3	65	EK Lunxheri	Faqja mbi Shendelli	3	K.dimerore	88	Kullote	MMPAU	K.Odrie	Ne perdorim
4	66	EK Lunxheri	Rrapi Koces	4	K.dimerore	44	Kullote	MMPAU	K.Odrie	Ne perdorim
5	67	EK Lunxheri	Rrapi Cingarit	5	K.dimerore	35,5	Kullote	MMPAU	K.Odrie	Ne perdorim
6	68	EK Lunxheri	Kemba e Leres	6	K.dimerore	92	Kullote	MMPAU	K.Odrie	Ne perdorim
7	69	EK Lunxheri	Kemba e Gurres	7	K.verore	130	Kullote	MMPAU	K.Odrie	Ne perdorim
8	70	EK Lunxheri	Hija e Vllahut	14	K.dimerore	28	Kullote	MMPAU	K.Odrie	Ne perdorim
9	71	EK Lunxheri	Gorrice e Minge	15	K.dimerore	58	Kullote	MMPAU	K.Odrie	Ne perdorim

Lidhja 1

[illegible]